



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

**RREGULLA PËR KRIJIMIN E SISTEMIT TË CERTIFIKATAVE TË
ORIGINËS PËR ENERGINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA
BURIMET E RIPËRTËRITSHME, MBETURINAT SI DHE NGA
BASHKËPRODHIMI I KOMBINUAR ME NXEHTËSINË, NË NJË NJËSI
TË VETME GJENERUESE**

Prishtinë, 29 dhjetor 2010

Bordi i zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenit 14.2.15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Nenin 13.5 të Ligjit për Energjinë, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.12.2010 miratoi Rregullën për Krijimin e Sistemit të Certifikatave të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme, Mbeturinat si dhe nga prodhimi i kombinuar me nxehtësinë, në një njësi të vetme gjeneruese (në vazhdim: Rregulla).

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1 Qëllimi i Rregullës, me Shtojcat që e shoqërojnë, është të përcaktojë kriteret e vendosjes, operimit dhe mirëmbajtjes së një sistemi për Lëshimin, Transferimin, Rimarrjen dhe Revokimin/anulimin e Certifikatave të Origjinës që i referohen energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, nga mbeturinat dhe nga gjenerimi i kombinuar me nxehtësinë, në pajtim me Nenin 9 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Neni 2

Përkufizimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1 "Certifikata e Origjinës"- një certifikatë e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji që përcakton përqindjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar certifikata që është prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë apo mbeturinat apo si bashkëprodhim energjisë elektrike dhe ngrohjes në një njësi gjeneruese.
 - 1.2 "KEEJL" nënkupton Komunitetin e Energjisë të Evropës Jug-Lindore;
 - 1.3 "ZRRE" nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji;
 - 1.4 "Njësi gjeneruese" nënkupton kombinimin e gjeneratorëve, turbinave dhe pajisjeve të tjera të lidhura dhe të instaluar së bashku në një lokacion të vetëm për prodhimin e energjisë elektrike;
 - 1.5 "Burime jo të ripërtëritshme të energjisë" nënkupton çdo burim primar energjie, të ndryshëm nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, që përdoret për prodhimin e energjisë elektrike;
 - 1.6 "Regjistër" nënkupton Regjistrin e Certifikatave të Origjinës të krijuar nga ZRRE, në pajtim me Nenin 5 të këtij Rregulli;
 - 1.7 "Zotërues i regjistruar në lidhje me Certifikatën e Origjinës", nënkupton personin, emri i të cilit shënohet në Regjistër si personi i fundit të cili është transferuar Certifikata e Origjinës, ose në rast se nuk shënohet në këtë mënyrë asnjë person, atëherë personi emri i të cilit shënohet në Regjistër si person të cilit i është lëshuar Certifikata e Origjinës;
 - 1.8 "Hollësitë e regjistruara" nënkupton informacionin e shënuar në Regjistër në lidhje me Certifikatën e Origjinës;
 - 1.9 "Burime të Ripërtëritshme të Energjisë" nënkupton burimet e ripërtëritshme jo-fosile të energjisë siç janë: era, energjia diellore, ujërat gjeotermale, energjia valore, energjia e ujit, bio-energjia, bio-masa dhe biogazet;
 - 1.10 "Kodi i Matjes" nënkupton Kodin e matjes të OSSH dhe Kodin e Matjes të OST.
 - 1.11 "Mbeturinat" do ta ketë kuptimin e përcaktuar me Direktivën 2001/77/EC.

- 2 Shprehjet e përdorura në këtë Rregull, kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike.

Neni 3

Energjia elektrike për të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës

- 1 Certifikatat e Origjinës lëshohen për energjinë e prodhuar elektrike, në territorin e Republikës së Kosovës:
 - (a) Nga burimet e ripërtëritshme të energjisë;
 - (b) Nga mbeturinat; dhe
 - (c) Nga gjenerimi i kombinuar me nxehtësinë në një njësi të vetme gjeneruese.
- 2 Në rastin e energjisë elektrike sipas paragrafit 1 pika (a) dhe (b) e këtij neni, të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe/apo mbeturinat dhe nga burime jo të ripërtëritshme të energjisë (lëndët djegëse konvencionale), të përdorur në kombinim, Certifikatat e Origjinës lëshohen për atë pjesë të energjisë elektrike që mund t'i atribuohet prodhimit si kur të jenë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe/apo nga mbeturinat në bazë të sasive relative të burimeve të ripërtëritshme primare dhe/apo energjisë nga mbeturinat dhe burimeve të tjera primare të energjisë (lëndë djegëse konvencionale) të përdorura për prodhimin e kësaj energjie elektrike.
- 3 Në rastin e energjisë elektrike sipas paragrafit 1 pika (c) e këtij neni të prodhuar nga burime të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme të energjisë të përdorura në kombinim, Certifikatat e Origjinës lëshohen për sasinë totale të energjisë elektrike të prodhuar. Certifikatat e Origjinës që tregojnë burimet e ndryshme të energjisë të përdorura, lëshohen në sasi që janë proporcionale me sasi të relative të burimeve të ndryshme të energjisë të përdorura për prodhimin e kësaj energjie elektrike.

KREU II

AUTORITETI PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË ORIGJINËS

Neni 4

Përcaktimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji si Autoritet për Lëshimin e Certifikatave të Origjinës

- 1 Certifikatat e Origjinës lëshohen nga ZRRE në pajtim me Nenin 9.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe duhet të njihen si e tilla nga të gjitha autoritetet në Kosovë.
- 2 ZRRE-ja vepron si Autoritet Kombëtar për Lëshimin e Certifikatave të Origjinës dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të marrë akreditimin e AIB (Asociacioni i Autoriteteve për lëshimin e Certifikatave të Origjinës) duke miratuar Rregullat dhe Procedurat si dhe duke hartuar Protokollin Kombëtar që kërkohet me rregullat e akreditimit të AIB.

Neni 5

Regjistri i Certifikatave të Origjinës

- 1 ZRRE duhet të krijojë dhe të mbajë Regjistrin e Certifikatave të Origjinës në pajtim me Nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
- 2 Regjistri duhet të mbahet në formë elektronike dhe duhet të përmbajë dy lloje të llogarisë:
 - (a) Llogaritë e të transferueshmeve;

- (b) Llogaritë e rimarrjes/realizimit.
- 3 Çdo Certifikatë e Origjinës do të përfshihet në Regjistër me hollësitë e regjistruara të përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj rregulle.
 - 4 Certifikata e Origjinës e regjistruar në llogarinë e rimarrjes/realizimit nuk mund të transferohet apo të rikrijohet.
 - 5 Regjistri do të bëhet publik, duke e publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, apo me anë të ndonjë mjeti tjetër që ZRRE e konsideron të përshtatshëm.
 - 6 Regjistri duhet të jetë përfundimtar në lidhje me atë nëse Certifikata e Origjinës është lëshuar apo ekziston dhe i referohet personit që në atë kohë është mbajtës i saj i regjistruar.
 - 7 ZRRE duhet të publikojë një shpjegim se si do të interpretohen kodet (shifrat) që përdoren në Regjistër.

Neni 6

Regjistrimi për lëshimin dhe mbajtjen e Certifikatave të Origjinës

- 1 Prodhuesit e energjisë elektrike sipas nenit 3 paragrafi 1 të kësaj rregulle, të cilët kërkojnë të pajisen me Certifikatë të Origjinës në relacion me atë energjinë elektrike të prodhuar, duhet të regjistrojnë në ZRRE njësinë (njësitë) gjeneruese për lëshim të Certifikatave të Origjinës.
- 2 Kërkesa për regjistrim duhet të dorëzohet me shkrim në ZRRE dhe duhet të përmbajë informacionin e përcaktuar në Shtojcën 2 të kësaj rregulle.
- 3 Brenda tridhjetë [30] ditëve pas pranimit të kërkesës ZRRE bën verifikimin se njësia (njësitë) gjeneruese, në lidhje me të cilën është dorëzuar kërkesa për regjistrim:
 - (a) Kanë të drejtën për lëshimin e Certifikatave të Origjinës në pajtim me Nenin 3 të kësaj rregulle;
 - (b) janë të pajisura me pajisje matëse në përputhje me Kodin e Matjes dhe Rregullat e Tregut; dhe
 - (c) nuk kanë kapacitete ndihmëse, konsumi i të cilave nuk përcaktohet nga ndonjë njehsorë dalës apo që njësia gjeneruese është përshtatur (futur) me njehsorë hyrës.
- 4 Brenda së njëjtës periudhë sipas paragrafit 3 të këtij neni, ZRRE e informon prodhuesin për rezultatin e verifikimit. Në qoftë se për njësinë gjeneruese kërkohet informacion shtesë në pajtim me Nenin 8 të kësaj rregulle, periudha e verifikimit pezullohet deri në marrjen nga ZRRE të informacionit të kërkuar, ose kur i është dhënë qasja në njësinë gjeneruese dhe ZRRE është dakord (pajtohet) që njësia gjeneruese për të cilën është dorëzuar kërkesa për regjistrim plotëson kushtet për lëshimin e Certifikatës së Origjinës. Në qoftë prodhuesit i refuzohet kërkesa, atëherë ZRRE i jep shkaqet kryesore të refuzimit.
- 5 Çdo person që ka ndërmend të kërkojë apo të pajiset me Certifikatë Origjine duhet t'i ketë llogaritë në Regjistër, të përcaktuara në Nenin 5, paragrafi 2 të kësaj rregulle.
- 6 Nuk do të lëshohet asnjë Certifikatë e Origjinës për ndonjë prodhues apo të transferohet te ndonjë person, përveç nëse prodhuesi apo personi i zotëron llogaritë në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni.

- 7 Aplikacionet për hapjen e llogarive sipas paragrafit 5 të këtij neni do të dorëzohen me shkrim në ZRRE. Ato duhet të përmbajnë:
 - (d) Emrin, adresën (nëse është korporatë, zyrën e regjistruar ose atë kryesore), dhe detaje të tjera kontakti dhe nëse është kompani, numrin e regjistrimit të personit që aplikon për të pasur llogaritë e veta në Regjistër;
 - (e) Nëse personi që aplikon për të pasur llogaritë e veta në Regjistër është prodhues i energjisë elektrike të përcaktuar në nenin 3, paragrafi 1 i kësaj rregulle.
8. ZRRE hap llogaritë në Regjistër brenda [5] ditëve të marrjes së aplikacionit, përveç nëse nevojitet informacion shtesë dhe kërkohet me Nenin 8 paragrafin 1 të kësaj rregulle, për të cilin rast llogaritë hapen brenda [5] ditëve nga marrja e këtij informacioni shtesë.
9. Në qoftë se prodhuesi ende nuk i posedon llogaritë sipas paragrafit 5 të këtij neni, atëherë ZRRE bën hapjen e këtyre llogarive, pa pasur nevojë për aplikacion të veçantë, kur kërkesa për regjistrim sipas paragrafit 2 të këtij neni vlerësohet pozitivisht.

KREU III
APLIKIMI, LËSHIMI, TRANSFERIMI, RIMARRJA, SKADIMI DHE REVOKIMI I CERTIFIKATAVE TË ORIGINËS

Neni 7

Aplikimi për Lëshim të Certifikatave të Origjinës

- 1 Certifikatat e Origjinës lëshohen pas kërkesës me shkrim të dorëzuar në ZRRE nga prodhuesi i energjisë elektrike sipas Nenit 3 paragrafi 1 i kësaj rregulle, për energjinë elektrike të prodhuar nga njësitë gjeneruese të regjistruara për lëshimin e Certifikatave të Origjinës në pajtim me Nenin 6 të kësaj rregulle. Kërkesa duhet të lidhet me energjinë elektrike të prodhuar gjatë një periudhe prej të paktën një [1] muaj dhe jo më gjatë se tre [3] muaj. Ajo duhet të dorëzohet jo më vonë se [3] muaj pas përfundimit të periudhës me të cilën ka të bëjë.
- 2 Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përmbajë informacionin e specifikuar në Shtojcën 3 të kësaj rregulle.
- 3 Kërkesa sipas paragrafit 1 i këtij neni duhet të shoqërohet me një deklaratë, të firmosur nga personi që e dorëzon kërkesën (në qoftë se kërkesa është bërë në emër të Korporatës, atëherë duhet të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i kësaj korporate) ku personi që e dorëzon kërkesën:
 - (a) Ka të drejtë në bazë të kësaj Rregulle t'i lëshohet Certifikata e Origjinës në relacion me energjinë për të cilën kërkesa është dorëzuar; dhe
 - (b) Nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë nga ndonjë Palë tjetër Kontraktuese të KEEJL ose në një Vend anëtar të Bashkimit Evropian, lëshimin e Certifikatave të Origjinës në lidhje me të njëjtën energji elektrike.

Neni 8

Qasja në informacion dhe njësitë gjeneruese

- 1 ZRRE ka të drejtë t'i kërkojë çdo personi që aplikon të hap llogaritë në Regjistër, ose çdo prodhuesi të energjisë elektrike që kërkon regjistrimin e njësisë gjeneruese për lëshimin e Certifikatave të Origjinës apo që kërkon lëshimin e Certifikatave të Origjinës që të sigurojë të dhëna apo informacion shtesë të nevojshëm për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së aplikacionit apo

- kërkesës. Kërkesa për informacion shtesë do të merret nga personi që dorëzon aplikacionin për hapjen e llogarive në Regjistër apo nga prodhuesi i energjisë elektrike që kërkon regjistrimin e njësisë gjeneruese për lëshim të Certifikatave të Origjinës apo që kërkon lëshimin e Certifikatave të Origjinës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e kërkesës sipas Nenit 6, paragrafi 2 dhe Neni 7 paragrafi 1 të kësaj rregulle apo brenda pesë (5) ditëve prej kur ZRRE pranon aplikacionin sipas Nenit 6 paragrafi 7 të këtij rregulli.
- 2 ZRRE ka të drejtë të ketë qasje në njësinë (njësitë) gjeneruese që prodhojnë energji elektrike sipas Nenit 3 paragrafi 1 të kësaj rregulle, kur kjo është arsyeshme dhe obligueshme për përmbushjen e funksioneve të ZRRE-së sipas kësaj Rregulle.
 - 3 Përbashimisht me përmbajtjen e Nenit 57.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, mos sigurimi i informacionit të kërkuar apo moslejimi i qasjes në njësinë (njësitë) gjeneruese siç përcaktohet në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, mund të rezultojë në refuzim nga ana e ZRRE-së për hapjen e llogarive të përcaktuara në Nenin 6 paragrafi 5 të kësaj rregulle, apo të lëshimit të Certifikatave të Origjinës në lidhje me energjinë elektrike të prodhuar nga prodhuesi i përfshirë apo nga njësia (njësitë) gjeneruese, të paktën deri në masën në të cilën nuk janë lëshuar ende Certifikatat e Origjinës.
 - 4 Çdo posedues i një llogarie sipas Nenit 5 paragrafi 2 të kësaj rregulle, duhet të mbajë (ruajë) të gjitha dokumentet dhe shënimet që kanë të bëjnë me zotërimin e Certifikatave të Origjinës për dhjet (10) vite nga data të cilës i referohet shënimi apo dokumenti.

Neni 9

Lëshimi, transferimi, rimarrja dhe skadimi i Certifikatave të Origjinës

- 1 Kur ZRRE pranon një aplikacion për lëshim të Certifikatave të Origjinës të dorëzuar në pajtim me Nenin 7 të kësaj rregulle duhet të lëshojë Certifikatat e Origjinës brenda një (1) **muaji** nga marrja e kërkesës, për aq sasi (por jo më shumë) të energjisë elektrike me të cilën ka të bëjë kërkesa, nëse përmbushet kushti që Certifikatat e Origjinës mund të lëshohen për këtë energji elektrike në pajtim me Nenin 3 të kësaj rregulle.
- 2 Periudha prej një [1] muaji për lëshimin e Certifikatave të Origjinës sipas paragrafit 1 të këtij rregulli mund të zgjatet në rast se ZRRE e sheh të nevojshme të kërkojë informacion shtesë apo qasje në njësinë (njësitë) gjeneruese që prodhojnë energji elektrike me të cilën ka të bëjë kërkesa, në pajtim me Nenin 8 të kësaj rregulle. Nëse ZRRE vlerëson që Certifikatat e Origjinës duhet të lëshohen, i lëshon Certifikatat e Origjinës brenda një [1] muaji pas marrjes së informacionit të kërkuar apo pas qasjes në njësinë (njësitë) gjeneruese.
- 3 ZRRE do ta përdorë dhe ka të drejtën të kërkojë shënimet e matjeve të Operatorit të Sistemit të rrjetit në të cilin janë lidhur njësitë gjeneruese, siç janë regjistruar në Bazën e të Dhënave të Barazimeve përfundimtare, për të verifikuar kërkesat për lëshim të Certifikatave të Origjinës. Në rast mospërputhje me Nenin 7 paragrafi 1 të kësaj rregulle, shënimet e matjeve nga Bazën e të Dhënave të Barazimeve përfundimtare do të mbizotërojnë.
- 4 Në rastin e energjisë elektrike të prodhuar sipas Nenit 3 paragrafit 1 pika c) e kësaj rregulle, ZRRE mund t'i kërkojë Operatorit të Sistemit të rrjetit në të cilin është lidhur njësia gjeneruese që të konfirmojë pjesën e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Në rast mospërputhje me Nenin 7 paragrafi 1 të kësaj rregulle, mbizotëron informacioni i siguruar nga Operatori i Sistemit.

- 5 Një Certifikatë Origjine duhet të lëshohet për çdo Megavat orë të energjisë elektrike sipas Nenit 3 të kësaj rregulle, duke e rrumbullakësuar në numrin e plotë më të vogël dhe më të afërm të Megavat orëve (MW/h). Çdo pjesë e mbetur e identifikueshme e Megavat orës (MW/h) do të bartet dhe do të shtohet sasisë së energjisë elektrike për të cilën janë lëshuar Certifikatat e Origjinës, në kërkesën pasuese që ka të bëjë me të njëjtën njësi gjeneruese.
- 6 ZRRE duhet t'ia lëshojë Certifikatat e Origjinës personit që e ka dorëzuar kërkesën apo personit tjetër që mund të caktohet nga personi që ka dorëzuar kërkesën.
- 7 Certifikatat e Origjinës të lëshuara në përputhje me këtë Nen regjistrohen në Llogaritë e Transferueshme të personit të cilit i lëshohen ato.
- 8 Kur Certifikata e Origjinës është lëshuar por nuk është anuluar, atëherë nuk mund të lëshohet asnjë certifikatë tjetër lidhur me energjinë elektrike për të cilën është marrë Certifikata e Origjinës.
- 9 Certifikata e Origjinës konsiderohet se është lëshuar vetëm atëherë kur ZRRE ka bërë regjistrimin e të dhënave në Regjistrin e përcaktuar në Nenin 5 të kësaj rregulle.
- 10 ZRRE i cakton një Numër rendor çdo Certifikate Origjine të lëshuar.
- 11 Nëse personi që zotëron Certifikatën e Origjinës i kërkon ZRRE-së transferimin e kësaj certifikate te ndonjë person tjetër, ZRRE duhet të bëjë transferimin, duke ndryshuar Llogaritë e Transferueshme në Regjistrin sipas Nenin 5 paragrafi 2 të kësaj rregulle, brenda 7 ditëve të marrjes së kërkesës për transferim. Të dhënat për Certifikatat e Origjinës që do të transferohen hiqen nga Llogaritë e Transferueshme të Personit që e bën transferimin dhe regjistrohen në Llogaritë e Transferueshme të personit të i cili bëhet transferimi. ZRRE-ja e konfirmon transferimin te personi që ka bërë kërkesën.
- 12 Zotëruesi i regjistruar i një Certifikate të Origjinës mund ta rimarrë atë, duke bërë kërkesë me shkrim në ZRRE. ZRRE bën transferimin e Certifikatës së Origjinës në Llogarinë e Rimarrjes të zotëruesit të regjistruar ose të ndonjë personi tjetër të caktuar nga ai brenda [7] ditëve të marrjes së kërkesës dhe i lëshon personit që dorëzon kërkesën një deklaratë për rimarrjen e Certifikatës së Origjinës.
- 13 Nëse nuk rimerret Certifikata e Origjinës në pajtim me paragrafin 12 të këtij neni apo nuk revokohet sipas Nenin 10 të kësaj rregulle, certifikata e origjinës skadon pas tetëmbëdhjetë [18] muajsh nga dita e parë në të cilën është prodhuar energjia elektrike për të cilën është lëshuar certifikata. Skadimi i Certifikatës së Origjinës shënohet në Regjistrin sipas Nenit 4 paragrafi 1 të kësaj rregulle. Certifikatat e Origjinës të cilat kanë skaduar nuk mund të transferohen apo rimerren.

Neni 10

Revokimi i Certifikatave të Origjinës

- 1 ZRRE do të revokojë Certifikatën e Origjinës kur:
 - (a) është e bindur që informacioni i siguruar në pajtim me Nenin 6 paragrafi 2 dhe 7 dhe Nenin 7 të kësaj rregulle, mbi bazën e të cilëve është lëshuar Certifikata e Origjinës është në veçanti materialisht (me të dhëna) jokorrekte apo që ajo Certifikatë e Origjinës është lëshuar në bazë të ndonjë sjelljeje, deklaratë apo veprimi mashtrues; ose
 - (b) vlerëson që Certifikata e Origjinës nuk duhet të ishte lëshuar, është e pasaktë apo që i është lëshuar personit të gabuar.

- 2 Kur ZRRE revokon Certifikatën e Origjinës, duhet ta njoftojë me shkrim zotëruesin e regjistruar të Certifikatës së Origjinës, sa më parë që të jetë e mundur.

KREU IV DIPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 11 Dispozitat kalimtare

Brenda 90 ditëve nga datës e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT) duhet të dorëzojë në ZRRE propozimet e tij për ndryshimet e nevojshme të Rregullave të Tregut - Barazimet përfundimtare, Kodit të Rrjetit dhe Kodeve të tjera teknike për zbatimin e dispozitave të dhëna në këtë Rregull.

Neni 12 *Ndryshimi i Rregullës*

- 1 Propozimi për ndryshim të kësaj rregulle mund të fillohet prej ZRRE-ja me iniciativë të saj, ose me kërkesë të ndërmarrjeve të energjisë.
- 2 Procedura për aprovimin e ndryshimeve të kësaj rregulle, do të jetë e njëjta me procedurën si për miratimin e saj.
- 3 ZRRE-ja, gëzon të drejtën që herë pas here, të nxjerrë udhëzime në lidhje me zbatimin e kësaj rregulle.

Neni 13 Gjuha zyrtare e rregullit

Ky Rregull nxirret në gjuhën Shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën Serbe dhe Angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën Shqipe.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data e aprovimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së:

Anëtarët e Bordit:

Shtojca 1

HOLLËSITË E REGJISTRUARA TË CERTIFIKATAVE TË ORIGJINËS QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË REGJISTËR

(sipas Nenit 5 të kësaj rregulle)

Hollësitë e regjistruara

1. Në lidhje me secilën Certifikatë të Origjinës të lëshuar në përputhje me Nenin 9 të kësaj rregulle:
 - (a) Emri dhe adresa e personit për të cilin është lëshuar Certifikata;
 - (b) Numri rendor i certifikatës ;
 - (c) Emri, vend-ndodhja dhe ndonjë informacion tjetër i nevojshëm për identifikimin e njësisë gjeneruese;
 - (d) Teknologjia e njësisë gjeneruese në të cilën është prodhuar energjia elektrike me të cilën ka të bëjë Certifikata e Origjinës dhe burimi apo burimet e energjisë të cilat janë përdorur për prodhimin e energjisë elektrike;
 - (e) Nëse Certifikata e Origjinës i referohet energjisë elektrike të prodhuar në kombinim me nxehtësinë në të njëjtin central;
 - (f) Fillimi dhe mbarimi i periudhës të cilës i përket Certifikata e Origjinës;
 - (g) Data e lëshimit ;
 - (h) Vendi ku prodhohet energjia elektrike me të cilën ka të bëjë Certifikata e Origjinës dhe emri i centralit, nëse ka të tillë, ku prodhohet energjia;
 - (i) Kapaciteti neto i deklaruar i njësisë gjeneruese dhe data kur është bërë operacionale¹;
 - (j) Nëse energjia elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës është pranuar në skemën mbështetëse në Kosovë, e ndryshme nga ndihma në investim, në të cilin rast duhet të shkruhet shënimi “Energjia elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës, ka marrë mbështetje nga një Skemë mbështetëse në Kosovë”.
2. Në lidhje me secilën Certifikatë të Origjinës që transferohet në përputhje me Nenin 9, paragrafin 11 të kësaj rregulle, emrin dhe adresën (Zyra e regjistruar apo kryesore nëse është korporatë) dhe nëse është kompani, numrin e regjistruar të personit të fundit të cili është bërë transferimi dhe të të gjithë zotëruesve të mëparshëm.
3. Në lidhje me Certifikatat e Origjinës që janë rimarrë në përputhje me Nenin 9 paragrafi 12 të këtij neni, datën në të cilën është bërë rimarrja dhe detajet e personit të emëruar në kërkesën e rimarrjes.
4. Në lidhje me Certifikatat e Origjinës që janë revokuar në përputhje me Nenin 10 të kësaj rregulle, datën e revokimit.
5. Në lidhje me Certifikatat e Origjinës që kanë skaduar, në pajtim me Nenin 9 paragrafi 13 të kësaj rregulle, datën e skadimit.

¹ kapaciteti neto i deklaruar nënkupton prodhimin më të lartë të energjisë elektrike (të llogaritur me anë të mbledhjes së bashku të prodhimit më të lartë të energjisë elektrike në терминалет kryesore të secilit alternator dhe dinamo) i cili, në bazë të supozimit që burimi i energjisë është pandërprerë në dispozicion, mund të mbahet pafundësisht pa i shkaktuar dëm njësisë gjeneruese, netoja e pjesës së asaj energjie elektrike që konsumohet nga njësi gjeneruese.

Shtojca 2

INFORMACIONI QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË KËRKESËN PËR REGJISTRIM TË NJËSIVE GJENERUESE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË ORIGINËS

(sipas Nenit 6 të kësaj rregulle)

1. Emri, adresa dhe certifikata e regjistrimit të biznesit të personit që kërkon lëshimin e Certifikatës së Originës;
2. Emri, vend-ndodhja dhe numri i identifikimit apo ndonjë informacion tjetër i obligueshëm për të identifikuar në mënyrë unike njësinë (njësitë) gjeneruese për të cilat kërkohet regjistrimi.
3. Teknologjia e njësisë gjeneruese dhe burimi apo burimet e energjisë që mund të përdoren për prodhimin e energjisë elektrike në njësinë gjeneruese;
4. Kapaciteti neto i deklaruar i njësisë gjeneruese dhe data kur ajo është bërë operacionale²;
5. Detaje për njehsorin (njehsorët) dalës të njësisë gjeneruese.
6. Detaje për ndonjë gjenerim për pajisjet e veta ndihmëse të lidhura në njësinë gjeneruese.
7. Kur ka gjenerim për pajisjet ndihmëse të lidhura me njësinë gjeneruese dhe kur konsumi i këtyre pajisjeve ndihmëse nuk matet nga Njehsori dalës, atëherë duhet të epen detajet e Njehsorit (Njehsorëve) hyrës, i cili përcakton konsumin e energjisë elektrike nga njësia gjeneruese.
8. Një përshkrim i mënyrës se si do të llogaritet, nga leximet e njehsorëve që duhet të sigurohen, shuma e Gjenerimit Neto të Energjisë Elektrike të prodhuar nga njësia gjeneruese.

² kapaciteti neto i deklaruar nënkupton prodhimin më të lartë të energjisë elektrike (të llogaritur me anë të mbledhjes së bashku të prodhimit më të lartë të energjisë elektrike në терминаlet kryesore të secilit alternator dhe dinamo) i cili, në bazë të supozimit që burimi i energjisë është pandërprerë në dispozicion, mund të mbahet pafundësisht pa i shkaktuar dëm njësisë gjeneruese, netoja e pjesës së asaj energjie elektrike që konsumohet nga njësia gjeneruese.

Shtojca 3

INFORMACIONI QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË KËRKESËN PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË ORIGINËS

(sipas Nenit 7 të kësaj rregulle)

1. Emri, adresa dhe certifikata e regjistrimit të biznesit të personit që kërkon lëshimin e Certifikatës së Originës;
2. Njësia gjeneruese në të cilën është prodhuar energjia elektrike për të cilën kërkohet Certifikata e Originës.
3. Burimi apo burimet e energjisë nga të cilat është prodhuar energjia elektrike për të cilën kërkohet Certifikata e Originës.
4. Nëse Certifikata e Originës që kërkohet i referohet energjisë elektrike të gjeneruar në kombinim me nxehtësinë në të njëjtin central.
5. Fillimi dhe mbarimi i periudhës që mbulohet nga kërkesa.
6. Sasia e energjisë elektrike për të cilën kërkohet Certifikata e Originës, bashkë me sasinë totale të energjisë elektrike të prodhuar nga centrali gjatë periudhës së referuar në pikën 5 të kësaj shtojce.